



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:121813

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06327447

C. nr. 343/ 2020

GJYKATA THEMELORE NË SKENDERAJ – DEGA NE SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni për çështje civile, me gjyqtarin Durim Osmani, në çështjen kontestuese të paditësit N.S., me vendbanim ne fsh..., Komuna Skenderaj, i përfaqësuar nga avokat L.A., ne baze te autorizimit, kundër të paditurit S.S. nga fshati..., Komuna Skenderaj, objekt kontestit Anulim i Ujdise gjyqësore, pas shqyrtimit paraprak te padisë, jashtë seancës gjyqësore me datë 21.10.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

I. Hedhet Poshtë padia e datës 20.08.2020, me shenj C. Nr. 343/2020 e paditësit N.S. nga fshati..., Komuna Skenderaj, me te cilin ka paditur palën e paditur S.S. nga fshati..., Komuna e Skenderajit, për Anulim te Ujdise Gjyqësorë, për shkak te kalimit te afatit ligjore – prekluziv për paraqitjen e padisë.

A r s y e t i m

Paditëse N.S. pran kësaj gjykate ka paraqitur padi për anulim te ujdise gjyqësore, me date 20.08.2020, kundër palës se paditur S.S., çështja kontestues ka marr numrin e lendes C. Nr. 343/ 2020.

Ne kërkesëpadi pala paditëse kërkon qe te anulohet ujdia gjyqësore e arritur dhe e pranuar pran Gjykatës Themelore ne Mitrovice – Dega ne Skenderaj, e datës 12.12.2013, me shenj C. Nr. 187/ 08.

Gjykata pas analizimit te thënieve ne padi, kërkesëpadi dhe shkresave te lendes rezulton se padia e paraqitur nga pala paditëse është e pas kalimit te afatit ligjor (prekluziv) për paraqitjen e padisë për anulim te ujdise gjyqësore dhe është dashtë te hedhet poshtë si e palejuar, ne kuptim te nenit 391 paragrafi f lidhur me nenin 418paragrafi 4 te Ligjit te Procedurës Kontestimore.

Ne baze te nenit 391 paragrafi f i Ligjit te Procedurës Kontestimore është përcaktuar se pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj;

Sipas nenit 418 paragrafi 4 te LPK -se është përcaktuar se padia për anulimin e pajtimit gjyqësor nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni mund të ngrihet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e marrjes së dijenisë për shkakun e anulimit, e më së voni brenda afatit prej një (1) viti nga dita e përfundimit të pajtimit gjyqësor.

Padia për Anulim te Ujdise Gjyqësore, me shenj C.nr. 343/2020 është dorëzuar pran gjykatës me date 20.08.2020, ndërsa, ujdia gjyqësore me shenj C.nr. 187/ 08 është arritur me date 12.12.2013, qe do te thotë se ka kaluar afati 1 vjeçare për paraqitjen e padisë.

Gjykata ka analizuar edhe pretendimin e palës paditëse ne tekstin e padisë se shkakun i paraqitjes se padisë për anulim te ujdise gjyqësore konsiston ne faktin se ne ujdinë gjyqësore te datës 12.12.2013, me shenj C.nr. 187/ 08, janë përcaktuar obligime për palën e trete N.S., i cili nuk ka marr pjese ne çështjen kontestuese c. Nr. 187/ 08 si pale ne procedure, gjykata këtë pretendim e ka vlerësuar si te pa baze, ngase, padinë për anulim te ujdise gjyqësore nuk e ka paraqitur N.S., por, vete nënshkruesi i ujdise gjyqësore N.S., gjykata nuk gjene interes juridik te paditësit qe te kërkoj nulitetin e ujdise, po ashtu, nëse analizohet ujdia gjyqësore c. Nr. 187/ 08, ne aktvendimin e shkruar ne procesverbal nuk rezulton se përcaktuar se pala e tret N.S. obligohet te paguaj shume te caktuar te te hollave ne dobi te palës se paditur S.S., por, vetëm është zbritur obligimi i marr përsipër nga N.S. ne lartësi prej 5,600.00 euro, nga obligimi i marr përsipër nga pala paditëse ne lartësi prej 14,000.00 euro, respektivisht, është përcaktuar obligimi vetëm për këtu palën paditëse qe te paguaj shumen e mbetur prej 8,400.00 euro, ne këtë kuptim, edhe po te qëndronin pretendimet ne kërkesëpadia te palës paditëse, prapë se prapë padia është paraqitur pas kalimit te afatit ligjor.

Duke marr parasysh te lartcekurat gjykata ka gjetur se padia (padia për anulim te pajtimit gjyqësor) e paraqitur nga pala paditëse është paraqitur pas kalimit te afatit ligjor për paraqitjen e padisë për anulim te ujdise gjyqësore, prandaj ka vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NE SKENDERAJ
C.nr. 343/2020, me datë 21.10.2024

Gjyqtari,
Durim Osmani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa brenda 15 dite pas pranimit te këtij aktvendimit, përmes kësaj gjykate për gjykatën e apelit.